

KËRKIME/RESEARCH

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR REVISTËN KËSHILLI BOTUES UDHËZIMET PËR AUTORET KONTAKTI

Informatë e përgjithshme në lidhje me revistën Research/Kërkime:

Research/Kërkime është revistë shkencore të cilën e boton Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Seksioni i Shkencave të Natyrës. Në këtë revistë botohen punime origjinale shkencore, kumtesa të shkurtra dhe punime revyale. Revista përfshinë Shkencat e Natyrës dhe ato të Zbatuara të cilat do të jenë të specifikuara në seritë A, B etj.

Artikujt duhet të shkruhen në gjuhën angleze me rezyme në gjuhën shqipe.

Dorëshkrimet e punimeve dorëzohen me E-mail në adresën: research@ashak.org

Dorëshkrimi duhet të jetë konform standardeve formale të revistës që janë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe atë angleze, shkarko dokumentin.

Dorëshkrimet e punimeve për këtë numër të revistës do të mund të dorëzohen deri më datën 30 nëntor 2017.

KËSHILLI BOTUES

Kryeredaktori:

[Salih Gashi](#), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 305, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

salihgashi@ashak.org

Sekretari:

[Fetah Podvorica](#), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 305, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

fetahpodvorica@ashak.org

[Qamil Haxhibeqiri](#), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 305, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

gamilhaxhibeqiri@ashak.org

Abdel Razik Sebak, Concordia University, Montreal, Kanadë

abdo@ece.concordia.ca

[Myzafer Limani](#), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 305, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

myzaferelimani@ashak.org

UDHËZIMET PËR AUTORËT

Qëllimi dhe fushë veprimtaria e revistës

Research është një revistë shkencore që i takon ASHAK-ut. Kjo është revistë “me qasje të hapur” që boton artikuj origjinal, punime revyale dhe kumtesa të shkurtra në kuadër të shkencave të natyrës dhe atyre të aplikuara. Punimet revyale me karakter të përgjithshëm të cilat i paraqesin arritjet në këto fusha, të dërguara me ftesë të këshillit redaktues të revistës nga autorët të cilët kanë kontribuar aktivisht për avancimet në atë fushë. Dorëshkrimet që paraqesin punime origjinale ose punime revyale nuk duhet të tejkalojnë numrin 5000 deri në 9000 fjalë.

Procedura e recensimit:

Procesi i recensimit bëhet me anonimitet të plotë. Këshilli redaktues do të kontaktojë recensent kompetentë në kuadër të disiplinës në të cilën është bërë hulumtimi shkencor. Përzgjedhja e recensentëve kompetentë është e rëndësishë së madhe. Pas përfundimit të raportit të recensentëve i cili përfshinë vërejtjet dhe rekomandimin, këshilli redaktues do t’ua dërgojë ato autorëve. Punimet të cilat kanë rekomandime të favorshme do të merren në konsideratë për botim.

Duke marrë në konsideratë se revista Research i mbulon shumë disiplina dhe i drejtohet një publiku më të gjerë, stili i të shkruarit dallon nga ai i revistave të specializuara. Punimet duhet të shkruhen në anglisht dhe nëse autori nuk e ka atë gjuhë amtare atëherë punimi shkencor duhet të korrigjohet për gjuhën e tij angleze sapo ai të marr rekomandime pozitive për publikimin e tij.

Revista publikon punime në këto lëmi: shkenca të natyrës dhe ato të aplikuara

Udhëzime për autorët:

Dorëshkrimi i punimit të dërguar me anë të postës elektronike duhet t’i përmbajë këto dokumente: dorëshkrimin e punimit, një letër sqaruese për botuesin dhe eventualisht material shtesë.

Deklarata e dorëzimit për botim:

Autori/ët deklarojnë se punimi i dorëzuar për botim nuk ka qenë asnjëherë i botuar më parë dhe se ai po ashtu nuk është tani duke u shqyrtuar për botim në ndonjë revistë tjetër. Emrat e autorëve dhe radhitja e tyre nuk mund të ndryshohen pas pranimit të punimit.

Etika në publikime:

Detyrë kryesore e autorëve është që të kontribuojnë me të dhëna origjinale dhe të bëjnë sqarim korrekt të rezultateve si dhe të ndikimit të tyre. Autorët janë tërësisht përgjegjës për përmbajtjen e kontributit të tyre shkencor. Autorët duhet të citojnë në mënyrë korrekte punimet shkencore të cilat kanë hapur rrugën për kryerjen e punimit të dorëzuar si dhe janë të domosdoshëm për sqarimin e fenomeneve që i hasim.

Bashkë autorët e punimit duhet të jenë individë të cilët kanë kontribuar shkencërisht në punim dhe të cilët janë përgjegjës për rezultatet. Kontributet e vogla përmenden në pjesën e falënderimeve.

Plagjiatura ndalohet prandaj autorët duhet të evitojnë kopjimin dhe parafrazimin shumë të përafërt të tekstit të punimit të dikujt tjetër ose të vetvetes. Për këtë arsye citimi korrekt gjatë gjithë punimit është i domosdoshëm në mënyrë që lexuesit të dinë për burimin e informacionit.

Struktura e punimit:

Punimi duhet të dorëzohet në version elektronik. Ai përmban titullin e punimit, emrat e autorëve, adresat e tyre profesionale, fjalët kyçe, hyrjen, pjesën eksperimentale, rezultatet dhe diskutimet, përfundimet, falënderimet dhe referencat.

Punimet origjinale mund të kenë maksimalisht 5000 fjalë ose hapësirën ekuivalente në figura, formula dhe tabela. Secila figurë ose tabelë numërohet sa 200 fjalë. Teksti i punimit shkruhet në Word, duke përdorur formatin Times New Roman 12.

Titulli i punimit: duhet të jetë i shkurtër, i qartë, i thuktë, dhe i ndërlidhur me përmbajtjen e punimit. Përdorimi i shkurtesave, formulave ose simboleve tjera nuk rekomandohet.

Emrat e autorëve dhe adresat e tyre profesionale. Secili autor duhet të ketë emrin dhe mbiemrin si dhe adresën e vet profesionale ndërsa autori korrespondent duhet të jetë i dallueshëm me shenjën e yllit si dhe duhet të ketë të dhënë adresën e Email-it.

Abstrakti: duhet të përmbajë informatë të shkurtër sa i përket risive në punim dhe i përmendë metodat e përdorura si dhe rezultatet kryesore.

Hyrja: në të përshkruhet problemi shkencor i cili studiohet në punim dhe jepet informacione relevante të rëndësishme të arriturave për atë lëmi. Hyrja përmban po ashtu informata për rezultatet kryesore që janë arritur deri më tani në këtë lëmi.

Pjesa eksperimentale duhet të paraqes qartë të gjitha procedurat, materialet dhe metodat të cilat përdoren për të kryer punën eksperimentale, rezultatet e së cilës janë dhënë dhe diskutuar në tekstin e artikullit shkencor. Llogaritjet teorike, metodat dhe softuerët të cilat janë përdorur duhet të jepen në rast të punës teorike. Metodot dhe procedurat standard mund të përshkruhen shkurtazi ndërsa për detaje më të hollësishme lexuesit udhëzohen të përdorin punimet tanimë të publikuara. Rezultatet eksperimentale ose llogaritjet teorike duhet të kenë të dhëna mjaft informata në mënyrë që t'ua mundësojnë hulumtuesve tjerë përsëritjen e tyre.

Rezultatet dhe diskutimi. Të gjitha rezultatet duhet të jenë origjinale, të paraqitura mirë dhe të mos përsëriten. Gjatë diskutimit të tyre duhet vënë në pah rëndësia e tyre për tematikën e hulumtuar si dhe duhet krahasuar ato me punën e ngjashme nëse është bërë më parë në kuadër të disiplinës.

Figurat dhe tabelat. Figurat shoqërohen me legjendat e tyre. Tabelat përpilohen në formatin e tekstit.

Simbolet, formulat dhe ekuacionet. Simbolet, formulat dhe ekuacionet shkruhen sipas rregullave të IUPAC dhe rekomandimeve për njësitë në sistemin SI. Për formula matematikore përdoret Editori i Matematikës.

Përfundimi. Në fund të punimit jepet një përmbledhje e rezultateve kryesore të punimit.

Referencat. Ato jepen në fund të punimit dhe numërohen ashtu si paraqiten në punim. Secila referencë paraqitet e veçantë. Referencat e punimeve të pa publikuara dhe referencat prej revistave jashtë platformës Scimago nuk pranohen. Vet-citimet janë të limituara deri në 30 % të numrit të përgjithshëm të referencave.

Citimi i referencave:

1. Brisset, F.; Vieillard, J.; Berton, B.; Morin-Grognon, S.; Duclairoir-Poc, C. and Le Derf, F. Surface functionalization of cyclic olefin copolymer with aryldiazonium salts: A covalent grafting method. Appl. Surf. Sci. 2015, 329, 337–346.

Citimi i librit:

1. Atkins, P. and de Paula, J. Elements of Physical Chemistry, Oxford University Press, Oxford, 2016, p. 122.

KONTAKTI

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 305, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel. +381 (0) 38249 303; E-mail: research@ashak.org

Publikuesi:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 305, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel. +381 (0) 38249 303; E-mail: research@ashak.org, www.ashak.org

Të drejtat autoriale ©ASHAK